



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Primjenor/Prodato Received/Delivery	02-09	2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org. Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SRMSH/CA	5923	2022	4/5	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.658/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës -Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi anëtarë, si dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.658/2022 të datës 26.07.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banim

kundër Vendimit me Nr.02-112/02-0060499/22 të datës 22.07.2022 të Kryetarit të Komunës së Podujevës, në çështjen juridike "transferim i përkohshëm", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 02.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.658/2022 e datës 26.07.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimi me Nr.02-112/02-0060499/22 i datës 22.07.2022 i Kryetarit të Komunës së Podujevës.
- III. Obligohet Kryetari i Komunës së Podujevës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesin në pozitën "Inspektor Tregut" sipas Akt Emërimit të datës 01.02.2019 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e tij e punës.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Ankuesi i punësuar në Komunën e Podujevës përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, më datë 26.07.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4303/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.02-112/02-0060499/22 të datës 22.07.2022 të Kryetarit të Komunës së Podujevës për transferim të përkohshëm, me pretendimet se vendimi është nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 28.07.2022 ka proceduar kërkesën e ankuesit për përgjigje në ankesë në Komunën e Podujevës. Ndërsa Këshilli, më datë 08.08.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 26.07.2022 me numër protokolli 4303/2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimit të datës 01.02.2019 të ankuesit; Vendimin me Nr.02-112/02-0060499/22 të datës 22.07.2022 të Kryetarit të Komunës së Podujevës; Formulari për kërkesë apo ankesë i datës 22.07.2022-kërkesë për transfer; Emailin e datës 26.07.2022 të ankuesit; E-mail zyrtar i datës 22.07.2022; E-mail zyrtar i datës 26.07.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 08.08.2022; Formulari për kërkesë apo ankesë i datës 22.07.2022-Pëlqim për transfer i datës; Përshkrimin i detyrave të punës për Inspektor i Tregut dhe Zyrtar për Regjistrimin e Bizneseve; Diplomën me Nr. 222/10 e datës 05.08.2010 për ankuesin; Diplomën me Nr. 1641/20 të datës 06.10.2020 për ankuesin.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesit, është e bazuar *sempse*:

Nga administrimi i provave materiale të kësaj çështje juridike, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesit sipas Akt Emërimit të datës 01.02.2019 është i punësuar në pozitën "Inspektor i Tregut" në Komunën e Podujevës. Më tutje pas kërkesës për transfer të datës 22.07.2022 të Drejtorit të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport për Drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit, me të cilën është kërkuar që të propozoni një zyrtar për transferim, ndërsa Drejtoria e Inspeksionit më datë 22.07.2022 ka dhënë pëlqimin për transferim ku ka propozuar që ankuesi është i përshtatshëm për kryerjen e detyrave në drejtorin përkatës.

Kryetari i Komunës së Podujevës më datë 22.07.2022 ka nxjerr Vendim me Nr.02-112/02-0060499/22 me të cilin ka bërë transferimin e përkohshëm të ankuesit nga pozita Inspektor i Tregut në pozitën Zyrtar ligjor.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.02-112/02-0060499/22 të datës 22.07.2022 të Kryetarit të Komunës së Podujevës për transferim të përkohshëm, pretendon që ky transferim është bërë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi konkretisht nenin 5 paragrafi 2 të Rregullores Nr. (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë sepse e ka nxjerr organi jo kompetent, është nxjerr në kundërshtim me nenin 52 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores Nr. (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, sepse nuk është përcaktuar kohëzgjatja e transferimit dhe se vendimi nuk përmban elementet e aktit administrativ sipas nenit 47 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon që Vendimi me Nr.02-112/02-0060499/22 i datës 22.07.2022 i Kryetarit të Komunës së Podujevës për transferim të përkohshëm është nxjerr në kundërshtim me legjislacionin në fuqi konkretisht nenin 5 paragrafi 2 të Rregullores Nr. (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë sepse e ka nxjerr personi jo kompetent, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 2 paragrafin 2.1 ku përcaktohet se: "1. Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1 kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve; 2. Transferimi mund të bëhet: 2.1 brenda institucionit ku është emëruar, duke përfshirë këtu edhe degët e tij lokale dhe mbi këtë bazë ligjore konstatohet se organi i punësimit ka të drejtë të që nëpunësin ta transferoj përkohësisht për interes të institucionit, mirëpo duke respektuar dispozitat e nenit 52 paragrafi 7 të të njëjtit ligji nga e cila dispozitë derivonë Rregullorja (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, e cila ka përcaktuar se: "Transferimi i përkohshëm në interes të institucionit, miratohet nga njësia përgjegjëse, e cila njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet. Për marrjen e këtij vendimi njësia përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësisht nga ana e nëpunësit të kritereve të pozitës të punës ku ai kërkohet të transferohet", në këtë kontekst e në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6 dhe nenin 14 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë njësi përgjegjëse kompetente për të nxjerrë vendimin për transferim është Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në kuadër të institucionit përkatës lokale ashtu si përcaktohen në këtë ligj: "1. Fjalët apo shprehjet e tjera, të përdorura në këtë ligj, kanë këtë kuptim; "1.6 Njësia përgjegjëse - është Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, të institucioneve të administratës shtetërore, përkatësisht *Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të institucionit dhe të institucioneve të tjera shtetërore*". Njësia e burimeve njerëzore si njësi përgjegjëse në këtë rast njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet dhe për marrjen e vendimit të tillë njësia përgjegjëse duhet të merr për bazë kriteret që kërkohen për këtë pozitë dhe hollësisht të argumentoj bazën ligjore dhe elementet tjera përmes vendimit të transferimit të përkohshëm, andaj sipas dispozitave të potencuara më lartë vendimi është nxjerr nga organi jo kompetent përderisa nuk kemi ndonjë provë të ofruar nga palët që arsyeton marrjen e kompetencës nga kryetari i komunës njësisë përgjegjëse të burimeve njerëzore dhe si i tillë ky vendim që është objekt i kësaj anekese është i kundërligjshëm dhe se nuk mund të prodhojë pasoja juridike, kështu që pretendimi i ankuesit është i bazuar në këtë aspekt.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar si me lartë, e në vështrim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konstaton se një akt administrativ i nxjerrë nga organi që nuk ka kompetencë, me shkelje të dispozitave procedurale dhe materiale është akt administrativ i paligjshëm, kështu që Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë dhe pa u lëshue në pretendimet tjera ankimore nga se vendimi është nxjerrë nga organi jo kompetentë sipas bazës ligjore të specifikuar më lartë, e duke u bazuar në autorizimet e përcaktuar me nenin 55 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka shfuqizuar Vendimin me Nr.02-112/02-0060499/22 të datës 22.07.2022 të Kryetarit të Komunës së Podujevës, duke obliguar këtë të fundit që brenda afatit të përcaktuar si në pikën III të dispozitivit ta kthej ankuesin në pozitën "Inspektor i Tregut" sipas Akt Emërimit të datës 01.02.2019 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e tij e punës.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda:A.nr.658/2022, datë 02.09.2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Podujevës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.